

RAPORT I AUDITUSIT TE PAVARUR
Për auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara
Fushata zgjedhore 2011
Periudha 7/04/2011 - 7/05/2011

PËR: KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Bulevardi: "Dëshmoret e Kombit"

Pallati i Kongreseve, Tirane

Të nderuar zotërinj,

Unë, Hidajete Kraja (Muçaj), në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.1232, dt.07.11.2011, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës të Shërbimit Nr.6440/1, dt.17.11.2011, kam audituar pasqyrat bashkëlidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore, që fillon me datë 07.04.2011 me regjistrimin e Partisë Demokratike të Bashkimit Musliman të Shqipërisë, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 07.05.2011 me përfundimin e fushatës zgjedhore të 08 Majit të vitit 2011. Kryetari i kësaj partie gjatë fushatës zgjedhore ka qënë z. Sabri Jacaj.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë Demokratike e Bashkimit Mysliman të Shqipërisë. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur mbi bazen e arketimeve dhe pagesave. Subjekti deklaron se nuk ka përfituar asnjë fond dhe nuk ka bere shpenzime. Subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Bashkimit Musliman të Shqipërisë nuk kishte hapur ndonjë llogari të posacme në ndonjë bankë për dhurimin e fondeve jopublike dhe nuk na u deklarua ndonjë numer llogarie si dhe asnjë dhurim për subjektin.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posacëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë cmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opiniononin tim të auditimit.

Adresa e Audituesit: Rr. "Çajupi", Pallati Fishta 2, kati 2, Shkodër.
Tel: 02249719, Cel: +355 69 40 69 929, e-mail: hydi_eka@yahoo.com


EKSPERTE
E REGJISTRUAR
KONTABEL
* HIDAJETE KRAJA *
R. LIC 107 DT. 21.12.00

